



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës (Komuna e Podujevës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Podujevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Për shkak të vonesave në pagesa dhe obligimeve të dala nga kontrata kolektive për pagesën e pagave jubilarë, shujtave dhe shpenzimeve të transportit në sektorin e arsimit, pagesat e ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishin në vlerë prej 554,016€, prej tyre shpenzimet shtesë për procedura përmbartimore ishin në vlerë prej 217,787€;
- A2 Mungesa e projekteve ekzekutuese;
- B1 Mangësi në menaxhimin e subvencioneve;
- B2 Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve;
- B3 Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor (30 ditë).

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Podujevës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Podujevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Podujevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Podujevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Podujevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: mos pajtueshmëri me rregullat tek investimet kapitale, subvencione dhe transfere dhe pagesa të ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore. Përveç këtyre kemi identifikuar çështje tjera në menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë, përfshirë keq klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurisë dhe llogaritë e arkëtueshme. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe janë bërë korrigjimet e mundshme.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, gjashtë (6) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbarrimore

Gjetja Neni 39 i LMFP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbarruesi.

Shuma e pagesave direkte nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore ishte 554,016€. Prej tyre 217,787€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurave të gjykatës/përmbarrimit. Këto mjete janë shpenzuar nga:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve në vlerë 529,986€, për pagesën shujtave dhe transportit në arsim dhe pagesën e pagave jubilarë; dhe
- Kategoria e mallra dhe shërbimeve në vlerë 24,030€.

Sipas Komunës kjo ka ndodh si rezultat i obligimeve të dala nga kontrata kolektive për pagesën e shujtave dhe shpenzimeve të transportit në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, pagesën e pagave jubilarë dhe vonesave në pagesën e faturave.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë informata të sakta dhe fonde të mjaftueshme për kategorinë e pagave dhe të adresojë këtë çështje tek Ministria e Financave, me qëllim që gjatë planifikimit të buxhetit të merret në konsiderim nëse është nevoja për buxhet shtesë për pagat jubilarë. Derisa, për vonesat tjera në pagesa të shtojë kontrollet në mënyrë që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mungesa e projekteve ekzekutuese

Gjetja Neni 20 pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". Ndërsa pika 13 "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në dy raste për kontratat: Asfaltimi i rrugëve në fshatin Peran në vlerë 176,883€ dhe Ndërtim i trotuareve në fshatrat, Sibofc i Poshtëm, Surkish, Dumnicë, Lupç i poshtëm, Llapashticë e poshtme, Kërpimeh, Pakashticë, Letanc, Konushfc, Gërdofc I, Gërdofc II, Halabak në vlerë 249,273€ Komuna nuk kishte hartuar projekte ekzekutuese, por kishte inicuar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë.

Shkaku i mungesës së projekteve ekzekutuese për ndërtimin/asfaltimin e rrugëve sipas zyrtarëve të komunës ishte mungesa e stafit për hartimin e tyre.

- Ndikimi** Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.
- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e subvencioneve

- Gjetja** Sipas thirrjes publike të datës 05.02.2021 për mbështetje financiare të klubeve, për organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Podujevës dhe thirrjes publike të datës 25.02.2021 për mbështetje financiare në projekt propozimet për prodhimin e shfaqjeve teatrale janë përcaktuar kriteret dhe Lista e dokumenteve për aplikim (një nga to ishte edhe vërtetimi që OJQ nuk ka obligime tatimore nga ATK). Sipas Rregullores MF-Nr. 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 10 paragrafi 1.5 përcakton: të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, nenit 23 kërkohet monitorimi dhe raportimi për projektet dhe programet në të cilat përfituesi i subvencionit raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta, ku raportimi përfshin raportimin narrativ dhe financiar dhe periudhat e raportimit.

Në vijim janë paraqitur mangësitë e identifikuara:

- Një Organizatë Jo Qeveritare (OJQ) në fushën e sportit ka përfituar subvencion në vlerë 1,250€ pa paraqitur dëshmi se kanë kryer obligime tatimore ndaj ATK;
- Një OJQ në fushën e kulturës kishte përfituar subvencion 9,000€ për shfaqje teatrale pa paraqitur dëshmi se kanë kryer obligime tatimore ndaj ATK, ku kjo OJQ ka bashkëngjitur vërtetimin por i cili ishte jo relevant sepse është i datës 20.08.2020 dhe përfaqësuesi i OJQ-së ishte i punësuar në teatër dhe kishte marrë pagë të rregullt nga teatri, ku përfaqësuesi i OJQ-së kishte dhënë një deklaratë se do të jetë

- pjesëmarrjes i shfaqjeve por nuk do të paguhet nga OJQ; dhe
- Një OJQ/Klubi i futbollit kishte përfituar 10,000€ subvencion por nuk kishte dorëzuar raport financiar.

Rastet e mësipërme kanë ndodhë si pasojë e vlerësimit jo të duhur sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike dhe kujdesit të pa pamjaftueshëm të zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e subvencioneve.

- Ndikimi** Mos respektimi i rregullores mund të dëmtoj kredibilitetin e procesit dhe mund të rezultojë që komuna të bashkëpunon me OJQ/individë të pa përshtatshëm. Kurse mungesa e raportimit të përfituesit e subvencioneve për shpenzimet e bëra mund të rezultojë në keqpërdorim të buxheteve dhe dështim në arritjen e objektivave komunale.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se Subvencionet menaxhohen në përputhje me Rregulloren dhe kërkesave për aplikim, si dhe përzgjedhja e përfituesve nga komisionet të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve

- Gjetja** Sipas nenit 6 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve (Plani Vjetor i Mbështetjes Financiare) kërkohet: “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit”.

Komuna edhe pse me Buxhet të Republikës së Kosovës ka parapa që gjatë vitit 2021 të ofrojë mbështetje financiare për projektet dhe programet e Organizatave jo Qeveritare, megjithatë nuk ka përmbushur kërkesën ligjore për përgatitjen e Planit Vjetor për mbështetje financiare të Organizatave jo Qeveritare.

Shkak i kësaj ishte neglizhenca e zyrtarëve kompetent për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare.

- Ndikimi** Mos përgatitja e planit vjetor rritë rrezikun që mjetet buxhetore të shfrytëzohen për qëllime tjera të paplanifikuara dhe në mos arritjen e objektivave të komunës në këtë fushë.

- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të Organizatave jo Qeveritare, ku ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe të dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit duke respektuar kriteret e rregullores për subvencionim të Organizatave jo Qeveritare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor (30 ditë).

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.

Në katër⁴ raste, faturat në vlerë totale 38,112€, nuk ishin ekzekutuar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, vonesat kanë tejkaluar afatin deri 184 ditë kalendarike.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i buxhetit dhe inicimi i proceduarve të shpenzimeve pa mjete në dispozicion.

Ndikimi

Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor rritë mundësinë që furnitorët ti drejtohen përmbauesve dhe gjykatave ku krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja A3 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategoritë ekonomike jo adekuate në vlerë prej 105,248€, si në vijim:

- Nga kategoria ekonomike mallrat dhe shërbimet janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë 95,248€, prej të cilave 73,464€ ishin paguar për investime kapitale (Rregullimi infrastrukturës përcjellëse në QKMF, mirëmbajtja dhe rindërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik, meremetimi i rrugëve me zhavor), ndërsa 21,784€ ishin paguar për subvencione (shpenzime të varrimit);
- Nga kategoria ekonomike investime kapitale janë planifikuar dhe realizuar pagesa në vlerë prej 10,000€ të cilat për nga natyra ishin mallra dhe shërbime (Mirëmbajtja e hapësirave publike parqeve dhe shesheve).

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë ekonomike adekuate.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, ndikojnë në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestnimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mungesa e kontrolleve në përgatitjen e Draft Pasqyrave Financiare Vjetore

Gjetja

Përgatitja e PFV-e duhet të bazohet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme si dhe sipas Rregullores së MFTP nr.01/2017 për Raportimin Vjetor Financiar të Organizatës buxhetore.

Komuna ka përgatitur dhe dërguar në Thesar PFV-të sipas afatit të paraparë deri me 30 janar. Megjithatë me rastin e rishikimit të PFV-e, nga ana e auditimit, janë vrejtur dhe korrigjuar në afatin e paraparë, disa çështje

të cilat i kemi rekomanduar Komunës për korigjim.

Çështjet e identifikuara janë:

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - te pjesa hyrja e parasë së gatshme të shtylla buxhetit fillestar, shënimi 8 të hyrat tatimore, Komuna ka prezantuar në PFV vlerën 355,314€ ndërsa sipas ligjit të buxhetit ishte vlera 465,314€;

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit - te pjesa hyrja e parasë së gatshme të shtylla buxhetit fillestar, shënimi 9 të hyrat jo tatimore, Komuna ka prezantuar në PFV vlerën 987,245€, ndërsa sipas ligjit të buxhetit ishte vlera 877,245€.

Me rekomandim të auditorëve, PFV janë korigjuar në afatin e paraparë.

Kjo kishte ndodh për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme dhe kujdesit të mangët të stafit përgjegjës në përgatitjen e PFV-ve.

Ndikimi

Paraqitja jo e drejtë dhe e saktë e të dhënave në PFV, jep një pasqyrim jo të plotë për shfrytëzuesit e PFV-ve. Si pasojë, kjo mund të ndikojë edhe në marrjen e vendimeve të gabuara nga vetë Komuna apo palët tjera të interesit.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, gjatë hartimit të pasqyrave për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative dhe të gjithë zërat në pasqyrat financiare të jenë drejtë dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 12,882,500€, prej tyre ishin shpenzuar 12,881,047€. Numri i të punësuarve të planifikuar me buxhet ishte 1,992 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,929.

Çështja A5 - Anashkalimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) gjatë rekrutimit

- Gjetja** Neni 17 i Ligjit Nr. 06/L - 114 Për zyrtarët publikë, paragrafi 4 përcakton se çdo institucion është i obliguar që të gjitha proceset, veprimet dhe procedurat lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore t'i kryejë përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).
- Numri i nëpunësve të rinjë në sektorin e arsimit për vitin 2021 ishte 141. Komuna për zhvillimin e procedurave të rekrutimit ka respektuar Ligjin për arsimin parauniversitar dhe Udhëzimin Administrativ 07/2017, ndërsa ka anashkaluar Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).
- Kjo ka ndodhur shkak i ndryshimeve që ndodhin shpesh në arsim sidomos zëvendësimeve për pushimet e lehonisë.
- Ndikimi** Kjo ndikon në menaxhimin jo të mirë të proceseve, veprimeve dhe proceduarve të rekrutimit në nivel të institucionit.
- Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë se proceset, veprimet dhe të gjitha procedurat lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzor kryhen përmes SIMBNJ, në pajtim me Ligjin për zyrtarët publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,080,078€, prej tyre ishin shpenzuar 5,640,364€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtim dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja A6 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ të Prokurimit Publik, pikat 61.6, 61.19 dhe 61.20 përcaktojnë se: “Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Në dy raste, kemi evidentuar vonesa deri në 133 ditë. Vonesat kanë të bëjnë me projektet si në vijim:

- Kontrata "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Majac" në vlerë 1,989€, e nënshkruar me datë 01.10.2021, vonesa deri 85 ditë; dhe
- Kontrata “Ndërtimi I bulevardit dhe sheshit të qytetit në vlerë 2,269,822€, e nënshkruar me datë 26.11.2019, vonesa deri 48 ditë.

Duhet theksuar se në asnjërin prej këtyre rasteve nuk kishte kërkesë/aprovim për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratave.

Sipas zyrtarëve komunal, shkak i vonesave në punë ishte pandemia COVID-19, megjithatë, vonesat janë reflektuar edhe nga mungesa e kontrolleve të brendshme.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të siguroj që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 96,577,318€, pasurive jokapitale është 1,932,579€, si dhe e stoqeve 116,171€.

Çështja B4 - Regjistri jo i plotë i pasurisë dhe raportim jo i drejtë i vlerësimit të pasurisë

Gjetja Sipas të Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare nenit 6.3 - "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria;

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Paga lidhur me memorandumin e bashkëpunimit për ndërtimin e qendrës së mjekësisë familjare, në vlerë 25,000€, nuk ishte regjistruar tek regjistri i pasurisë mbi 1000€;
- Në regjistrin e e-pasurisë në gjashtë⁵ raste, komuna nuk kishte regjistruar pasurinë në vlerë prej 33,348€;
- Po ashtu komuna kishte shpalosur në PFV vlerën e përcaktuar nga komisioni i vlerësimit në departamentin e QKMF në vlerë 381,320€, derisa vlera e përgjithshme e regjistrit të e-pasurisë tek departamenti në fjalë në fund të vitit 2021 ishte 209,494€.

Mos regjistrimi i pasurisë në SIMFK dhe e-pasuri sipas zyrtarëve ka ndodhur si pasojë e mungesës së koordinimit në mes të departamenteve.

Ndikimi Regjistri jo i plotë i pasurive, rezulton me mangësi informatash për pasuritë dhe raportim jo të drejtë të tyre. Po ashtu, rrit rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit të tyre.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Sipas nenit 19.4.3 të rregullores MF- nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore - Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur; nenit 3 i rregullores përcakton se komisioni për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare - nënkupton Komisionin e formuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) në organizatën buxhetore me qëllim të vlerësimit të pasurive jo financiare; neni 4.6 - Zyrtari Kryesor Administrativ themelon Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare. Po ashtu, sipas nenit 4.1 Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.

Kryetari ka emëruar komisionin e inventarizimit i cili ka arritur të kryej inventarizimin e pasurisë jo financiare për vitin 2021. Mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe, rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit.

Po ashtu, drejtori i QKMF-së kishte themeluar një komision për vlerësimin e e-pasurisë në QKMF krahas komisionit të vlerësimit i themeluar nga ZKA. Raporti i vlerësimit nuk ka paraqit vlerësimin sipas pozicioneve individuale të pasurisë së vlerësuar. Vlerat ishin vendosur në mënyrë komulative sipas reparteve të QKMF-së .

Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për ndarjen e drejt të detyrave për regjistrimin dhe raportimin e pasurive, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, ngarkimin e pasurive tek personat përgjegjës që do të kujdeseshin për pasuritë e ngarkuara apo edhe procedurën e inventarizimit dhe krahasimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së njohurive nga ana komisionit mbi përgjegjësinë për harmonizimin e gjendjes së pasurisë pas realizimit të inventarizimit e pastaj edhe ngritjes së komisionit të vlerësimit nga ana e drejtorit të QKMF-së.

Ndikimi

Mungesa e rregullave të brendshme dhe mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B5

Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj që vlerësimin e pasurisë të realizoj vetëm komisioni i formuar nga ai dhe raportet të jenë të detajuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,348,898€. Pjesa më e madhe i takon tatimit në pronë në vlerë 3,367,081€ apo rreth 77%, qiraja komunale në vlerë 966,181€ apo rreth 22% dhe të tjera në vlerë 15,636€.

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Në krahasim me vitin paraparak rritja ishte rreth 181,708€ për tatimin në pronë dhe qiratë komunale.

Komuna kishte marr vendim për shkëputjen e kontratave me qiramarrësit, të cilët nuk kanë kryer obligimin e qirasë ndaj komunës. Në vendim parashihet nëse qiramarrësit nuk kryejnë pagesën e borgjit në afatin prej 10 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, realizimi i borgjit do të bëhet me procedurë përmbaruese/gjyqësore, mirëpo komuna nuk kishte ndërmarr masat e parapara sipas vendimit për inkasimin e borgjeve të mbetura që nga viti 2017.

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B6

Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	23,853,655	25,092,539	22,218,657	24,798,321	23,612,094
Grante Qeveritare - Buxheti	21,385,798	21,681,242	20,767,918	20,457,169	19,751,426
Financimi përmes huamarrjes	0	75,875	75,565	185,183	41,774
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,125,298	1,125,298	0	2,616,508	2,411,286
Të bartura nga viti i kaluar	0	669,619	458,564	639,185	426,914
Të hyrat vetanake	1,342,559	1,342,559	868,016	719,769	751,272
Donacionet vendore	0	197,424	48,594	110,577	29,550
Donacionet e jashtme	0	522	0	69,930	199,872

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,238,884€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprak, rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të qeverisë. Në vitin 2021 komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit final, me një rënie prej 0.3% në krahasim me vitin 2020.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	23,853,655	25,092,539	22,218,657	24,798,321	23,612,094
Pagat dhe mëditjet	12,550,000	12,882,500	12,881,047	12,183,282	11,851,579
Mallrat dhe shërbimet	2,533,578	2,812,107	2,583,473	2,228,095	1,892,718
Komunalitë	420,000	420,000	410,040	326,745	395,150
Subvencionet dhe transferet	750,050	897,854	703,733	1,122,703	566,758
Investimet Kapitale	7,219,096	8,080,078	5,640,364	8,937,496	8,905,889
Rezervat	380,930	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 332,500€ si rezultat i vendimit të qeverisë në shumë 256,386€, po ashtu, me vendim të qeverisë kishte zvogëlim për 1,454€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 278,529€ si rezultat i rishikimit në vlerë 14,940€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 256,387€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve 7,202€.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 147,804€, si rezultat i vendimit të qeverisë në shumë 27,700 dhe granteve të përcaktuara të donatorëve 120,104€.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 860,982€ si rezultat i të hyrave të batuara nga viti i kaluar në vlerë 413,233€, granteve të përcaktuara të donatorëve 70,639€, rishikimit të buxhetit 16,180€, vendimit të kuvendit komunal 380,930€ dhe një zvogëlimi prej 20,000€ me vendim të qeverisë.
- Buxheti final për rezerva në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar 380,930€, mjete të cilat ishin transferuar në investime kapitale me vendim të kuvendit komunal.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Podujevës në 2021 ishin në vlerë 1,427,378€€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 264,548€ (gjobat në trafik 236,722€, të hyrat nga gjykata në vlerë prej 23,040€ dhe të hyrat nga agjencioni pyjeve 4,786€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	1,342,559	1,342,559	1,427,378	936,982	1,204,633
Të hyrat tatimore	877,245	877,245	685,098	345,801	441,455
Të hyrat jo tatimore	465,314	465,314	739,571	591,181	763,178
Të hyrat tjera	0	0	2,709		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tetë (8) rekomandime janë zbatuar; gjashtë (6) nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurohet se blerja e shërbimeve apo produkteve të bëhet sipas procedurave adekuate të prokurimit. Në rastet kur financimi është nga donatorët të definohet me marrëveshje të financimit/grantit se çfarë procedura të prokurimit parashikohen të zhvillohen.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar

3.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim. Po ashtu, gjatë vendosjes së kriterëve në ftesa publike të qartësohet saktësisht se nga cili institucion relevant dhe i besueshëm plotësohen kriteret e kërkuara.	Nuk ka filluar implementimi i rekomandimit.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia të zyrarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.	Komuna nuk kishte pregaditur dhe dorezuar planin për subvencionim të OJQ në zyrën e kryeministrit.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit dhe zyra e prokurimi të forcoj kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurohet që çdo herë kur paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet përmes menaxherëve të kontratës se po respektohen kushtet e kontratës kur porositen shërbime apo punë të nevojshme. Po ashtu, të mos lejohet tejkalimi i sasive të parashikuara përtej limiteve të lejuara për kontratat kornizë.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i kontratës duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës të bëjë kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar

10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të kontratave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara në përputhje me kushtet.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se sistemi e-Pasuria përdoret nga zyrtari i pasurisë dhe se aplikohet norma e zhvlerësimit. Të gjitha pasuritë mbi dhe nën 1,000€ duhet të regjistrohen në sistemet përkatëse në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, Kryetari në bashkëpunim me MF, të sigurohet se për pasuritë e shitura apo të dhuruara merren veprimet e nevojshme që ato fshihen nga regjistrat e pasurive.	Komuna edhe këtë vit nuk ka regjistruar të gjitha pasuritë e blera përvetësuar.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Gjithashtu të siguroj se është duke u respektuar rregullorja për pasuritë financiare dhe jo financiare.	Komuna nuk ka bërë hartimin e rregulloreve të brendshme dhe nuk është duke bërë regjistrimin e pasurive drejt në regjistër.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu, duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Obligimet e papaguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhën brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Nuk ka filluar zbatimin i rekomandimeve.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujevo - Municipality of Podujeva



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Podujevës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe ;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Shpejtim Bafilqi

Kryetar i Komunës,

Data: 09.06.2022



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Ndricimi publik, 4,375.39€; Mirëmbajtja e objekteve shkollore, 6,000€; Meremetimi i rrugëve lokale, 325.06€; Furnizime mjeksore, 27,412€
- ⁵ Furnizim per zyre, 680,40€; Pajse tjera,990€, Pajse tjera,514,45€, Blerje e kompresor,4,875 € Pajse tjera, 2,730 € Furnizim e pajse per zjarrfiks,4,550 € Furnizim per zyre,1,333€, Pajse speciale mjeksore,8,000 € Pajse speciale mjeksore,10,000 € Pajse tjera,175,00 €.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.